

Çmimi i energjisë elektrike: trendet e ndryshimit dhe ndikimi ekonomik

Ky punim është përgatitur nga Instituti për Studime të Avancuara GAP dhe Forumi për Iniciativa Qytetare në kuadër të Konsorciumit Kosovar të Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm (KOSID).

Mars 2013

Përmbledhje Ekzekutive

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) është në përfundim të procesit të shtatë të shqyrtimit të tarifave të energjisë elektrike në Kosovë. Ky proces merr parasysh një varg faktorësh të cilët ndikojnë në çmimin e energjisë elektrike. Këto faktor mbledhen në fund për të caktuar të hyrat maksimale të lejuara për operatorët ekonomik të fushës së energjisë. Pas caktimit të të hyrave maksimale të lejuara, caktohen edhe tarifat për energjinë elektrike. Për dallim nga praktikat në të kaluarën, ZRRE për herë të parë do të aplikojë caktimin e të hyrave maksimale të lejuara për operatorët ekonomik në afat prej pesë viteve.

Trendet e ndryshimit të faktorëve të cilët përcaktojnë çmimin e energjisë elektrike janë të ndryshëm. Në njërin anë, faktorët si kostoja operative, kostoja e mirëmbajtjes, importi i energjisë, dhe kostoja kapitale do të rriten dhe do të ndikojnë negativisht në çmim si pasojë e rritjes së taniemës në qymyr, rritjes së rrogave të punëtorëve, rritjes së importit i cili kushton shumë më shtrenjtë sesa energjia e prodhuar në vend, dhe mjeteve që priten të investohen në të gjithë sektorët, sidomos në atë të distribucionit. Faktorët tjerë, si zvogëlimi i humbjeve komerciale, humbjeve teknike, dhe inkuadrimi i faktorit të efikasitetit do të ndikojnë pozitivisht në çmimin e energjisë elektrike. Në anën tjetër, faktorë si zhvlerësimi i kapitalit, investimet e huaja në formë të granteve, subvencionet e qeverisë ndaj sektorit energjetik, mungesa e investimeve në mbrojtje të ambientit, dhe fuqia e lirë punëtorë kanë ulur çmimet e energjisë elektrike deri më tani dhe në përgjithësi do të duhej të mbanin çmimin e ulët.

Në krahasim me vendet e rajonit, Kosova paguan më shume për kWh sesa Serbia dhe Maqedonia, ndërsa çmim më të ulët se Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, dhe Mali i Zi. Kurse 27 vendet e Bashkimit Evropian në mesatare paguajnë rreth 14.16 cent për kWh, apo rreth 3 herë më shumë sesa Kosova. Por përkundër faktit që kosovaret paguajnë çmim relativisht të ulët në krahasim me rajonin, po të përfshihet standardi i jetesës dhe parimi i fuqisë blerëse në modelin e krahasimit, atëherë shihet që kosovaret paguajnë mesatarisht 52% më shumë për energji elektrike sesa qytetarët në cilindo shtet tjetër në rajon apo në BE.

Gjithashtu, rritja e çmimit të energjisë do të rendonte gjendjen ekonomike dhe sociale të qytetareve të Kosovës. Rritja e çmimit të energjisë do të ndikonte në rritjen e shpenzimeve për banim dhe në rritjen e shpenzimeve për ushqim. Këto dy kategori janë ekzistenciale dhe përbejnë më shumë se dy të tretat e buxhetit të një kosovari. Në përgjithësi, një ngritje e çmimit të energjisë elektrike për 10 përqind, do të ndikojë në rritjen e Indeksit të Çmimeve të Konsumit për 1 përqind. Përveç efekteve direkte, ngritja e çmimi të energjisë elektrike do të ndikonte edhe kursimet dhe koston e prodhimit vendor. Këto dy efekte, edhe pse janë më vështirë të identifikueshme në indikatorët e thjeshtë ekonomik, kanë peshë të madhe dhe ndikim negativ në ekonomi.

Në bazë të të gjeturave të këtij punimi, Instituti GAP dhe FIQ rekomandojnë që humbjet komerciale të eliminohen në kohen me të shpejtë të mundur, ndërsa humbjet teknike të zvogëlohen deri në masën optimale, Qeveria e Kosovës të ulë TVSH-në për energjinë elektrike, Qeveria e Kosovës duhet të ulë taniemën për linjitin i cili do të përdoret në Kosovë, dhe faktori i efikasitetit të jetë më i lartë në fillimin e aplikimit të tij.

1. Hyrje

Tregu i energjisë elektrike është treg në të cilin kompanitë nuk mund të hyjnë dhe të dalin lehtë. Kostoja e madhe kapitale për hyrjen e një kompanie në këtë treg paraqet një barrierë të madhe. Kurse, përgjegjësia për të furnizuar me energji ekonominë prodhuese dhe familjare paraqet barrierë dalëse nga ky treg. Si rezultat, tregu i energjisë elektrike, sidomos tregjet e vogla si rasti i Kosovës, ka tendencë që të prodhojë korporata të mëdha të cilat kontrollojnë një pjesë të madhe të tregut. Kjo i jep fuqi të monopolit këtyre korporatave, dhe si rezultat, tregu edhe pse i lirë, mund të mos jetë eficient.

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë dominohet nga monopolet. Në fushën e gjenerimit, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) mban nën kontroll rreth 97% të të gjithë energjisë së prodhuar. Ndërsa rrjeti i transmisionit dhe i distribucionit, i cili përfshinë edhe furnizimin, janë nën monopolin e plotë të operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), respektivisht konsorciumi Limak-Çalik. Kjo e fundit, pritet të merr nën kontroll distribucionin dhe furnizimin gjatë muajit Maj pasi që doli fituese nga procesi i privatizimit, i cili përfundoi në tetor të vitit 2012.

Njëra ndër karakteristikat e monopoleve është çmimi i fryrë, i cili në kushte të konkurrencës do të ishte më i ulët. Për të mos lejuar sjellje të tilla monopoliste dhe për të rregulluar tregun e energjisë në përgjithësi, Kuvendi i Kosovës në vitin 2004 duke ndjekur praktikën e shumë vendeve tjera, aprovoi Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, me të cilin formon Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE). Si rrjedhojë, ZRRE ka për detyrë, ndër të tjera, “që asnjë ndërmarrje për energji të mos abuzojë me pozitën dominuese dhe ndalimin e praktikave jo-konkurruese” dhe “që interesi në mes konsumatorëve dhe ndërmarrjeve për energji të jetë i balancuar mirë.”¹ Njëra ndër metodat që ZRRE përdorë për të arrit këtë qëllim, që në fakt është edhe njëra ndër detyrat e ZRRE, është përcaktimi i çmimit të energjisë elektrike.

Kjo analizë ka për qëllim përshkrimin e metodës së përcaktimit të tarifave të energjisë elektrike, t’i analizojë variablat dhe trendet e ndryshimit të tyre, dhe të vlerësojë ndikimin e çmimeve në ekonomi.

¹ Ligji nr. për Rregullatorin e Energjisë http://www.assembly-kosova.org/common/docs/liqjet/2004_9_al.pdf

2. Rruga deri tek tarifa

Edhe pse ZRRE u formua në vitin 2004, shqyrtimin e parë të tarifave e ka filluar në vitin 2006 dhe tarifatat e vendosura ishin vjetore. Procesi i vendosjes së tarifave vjetore ka vazhduar deri në 2012, ndërsa prej 2013 tarifatat do të vendosen për një periudhë shumëvjeçare². Për të caktuar çmimin e energjisë elektrike, ZRRE përcakton të hyrat maksimale të lejuara për kompanitë të cilat operojnë në treg të energjisë (të licencuarit). Ndërsa të hyrat maksimale të lejuara llogariten nga kostot e përlllogaritura të të licencuarve. Pas marrjes së të dhënave nga kompanitë në treg nëpërmjet formularëve të raportimit, ZRRE përpilon vlerësime të përkohshme dhe raporte konsultative të cilat u dërgohen të licencuarve për komentim. Pas komentimeve dhe konsultimeve nga të licencuarit dhe ZRRE, mbahen edhe dëgjime publike. Ndërsa pas dëgjimeve publike vendoset për të hyrat maksimale të lejuara. Në fund të licencuarit propozojnë tarifatat dhe ngarkesat për aprovim, dhe ZRRE merr vendimin përfundimtar.

Në përgjithësi procesi i caktimit të tarifave të energjisë elektrike është proces i ndërlikuar, në të cilin marrin pjesë shumë variabla. Gjer më tani, procesi i përcaktimit të tarifave zakonisht ka zgjatur afërsisht 4 muaj. Tani, meqë të hyrat maksimale të lejuara do të caktohen për një periudhë shumëvjeçare, procesi ka filluar në qershor të 2012 dhe do të përfundojë në fund të marsit të 2013 (10 muaj). Në këtë proces llogariten të hyrat maksimale të lejuara për kompanitë e të katër sektorëve energjetik: gjenerimit, transmisionit, distribucionit, dhe furnizimit. Ndërsa për secilën kompani individualisht llogariten kosto operative dhe e mirëmbajtjes, zhvlerësimi, kthimi i lejuar në kapital, kosto e lejuar e furnizimit me thëngjill dhe lëndë tjera djegëse, humbjet e lejuara, taksa e licencës, kosto e lejuar e borxhit të keq, kosto e importit, dhe kosto tjera. Duhet cekur që ZRRE nuk rregullon divizionin e minierave. Megjithatë, për shkak të mungesës së kontratave fikse në mes të divizionit të gjenerimit dhe kompanive prodhuese të linjitet ku do të përcaktohej çmimi dhe sasia e thëngjillit ndër vite, ZRRE është e detyruar të bëjë të njëjtat përlllogaritje edhe për këtë divizion në mënyrë që të përcaktojë çmimin e linjitet, i cili përbën një ndër kostot kryesore variabla të koston totale të divizionit të gjenerimit.

Të hyrat maksimale të lejuara, të caktuara në vitin e parë, azhurnohen çdo vit pas ndryshimit të pritshëm të rrethanave. Këto azhurnime, apo shqyrtime periodike, saktësisht vjetore, faktor kryesor kanë vlerën aktuale të inflacionit të matur, duke përdorur Indekset e Harmonizuara të Çmimeve të Konsumatorëve, faktorin e efikasitetit, i cili vendoset në fillim për të gjithë vitet që pasojnë, dhe faktorin profilizues, i cili përcaktohet gjatë shqyrtimit periodik. Përveç këtyre faktorëve, në shqyrtimet periodike merren parasysh edhe ndryshimet në humbjet e lejuara, bilanci i prodhimit të linjitet dhe ndryshimet potenciale në çmimin, bilanci i importit dhe eksportit, ndryshimet në çmimet e tyre, dhe ndryshime tjera. Ndryshimet tjera të forcës madhore apo që janë jashtë përgjegjësisë dhe kontrollit të të licencuarve, i japin të drejtën të licencuarve të kërkojnë shqyrtim të jashtëzakonshëm.

² Shqyrtimi i shtatë i tarifave të energjisë elektrike - Vlerësimet e përkohshme http://ero-ks.org/Tarifat/2012/Vleresim_i_perkoshem_dokument_i_perqitheshem_KEK.pdf

3. Faktorët që luajnë rol në çmim të energjisë elektrike dhe trendet e ndryshimit të tyre

Ka shumë faktorë që ndikojnë në përcaktimin e çmimit të energjisë elektrike. Më tutje do të identifikojmë secilin faktor veç e veç dhe të analizojmë trendet e ndryshimit të tyre.

Kosto Operative dhe e Mirëmbajtjes, është kostoja me peshën më të madhe për të gjitha divizionet. Në këtë kosto përfshihet furnizimi me linjit dhe lëndë tjera djegëse, pagat e punëtorëve, riparimi dhe mirëmbajtja, shpenzimet komunale, kostot e sigurisë dhe transporti i punëtorëve brenda vendit të punës.

Ndryshimi më i madh që pritet të ndodhë brenda kategorisë së koston operative dhe të mirëmbajtjes është rritja e çmimit të lëndës bazë djegëse, linjtit, si rrjedhojë e rritjes së çmimit të tantimës në linjit nga 0.27 euro në 3 euro për ton. Minierat prodhojnë rreth 8.2 milion ton linjit³ për vit, ndërsa për të prodhuar energji elektrike përdoren rreth 5 milion ton⁴. Ky vendim, qeverisë i sjellë rreth 22 milion euro nga prodhimi i linjtit në përgjithësi, dhe ngarkon specifikisht prodhimin e energjisë elektrike me një kosto ekstra prej 13.5 milion euro. Duhet cekur që një pjesë e rritjes së tantimës është përfshirë në çmimin e energjisë elektrike për vitin 2012-2013, por që pritet që edhe përfshirja e pjesës tjetër të ndikoj në rritjen e çmimit të energjisë elektrike.

Një faktor tjetër kyç i cili do të ndikojë në çmimin e energjisë elektrike është rritja e buxhetit të dedikuar për rroga të punëtorëve. Punëtorët e të gjitha divizioneve të KEK-ut, të cilët nuk kanë përjetuar rritje të pagave për një periudhë të gjatë, kanë kërkuar rritje pagash prej 30%, që në terma absolut do të thotë rritje prej 13,8 milion euro. Ndërkaq KEK propozon rritje reale prej 5% (përmbi vlerën e inflacionit).⁵ Kjo kërkesë për rritje të pagave mund të balancohet nga fakti që një numër i konsiderueshëm i punëtorëve të sektorit të energjisë elektrike pritet të pensionohen dhe të mos zëvendësohen. Vetëm në divizionin e minierave pritet që numri i punëtorëve të bie për 286 deri në vitin 2017.

Kosto Kapitale është kategoria e dytë e kostove. Në këtë kategori bëjnë pjesë investimet kapitale të bëra nga kompanitë energjetike dhe kthimi në investim. Sipas kontratës të nënshkruar në mes të Qeverisë së Kosovës dhe konsorciumit Limak-Çalik, kjo e fundit në 15 vitet e ardhshme duhet të investojë në rrjetin e distribucionit 300 milion euro. Për 5 vitet në vijim, planifikohet që të investohen diku rreth 114.1 milion euro në rrjetin e distribucionit.⁶ Këto investime do të reflektojnë në ngritjen e çmimit të energjisë elektrike.

³ Bilanci i Energjisë në Kosovë TM2-2012, Agjencia e Statistikave të Kosovës. Burimi: http://esk.rks.gov.net/energja/publikimet/doc_view/932-bilanci-i-energjisaeuml-naeuml-kosovaeuml-tm2-2012?tmpl=component&format=raw

⁴ Vlerësimi fillestar i formularëve të KEK-ut. Burimi: ZRRE, http://ero-ks.org/Price%20and%20Tariffs/2012/albanian/Vleresimi_fillestar_KEK_shqip.pdf

⁵ Vlerësimi i përkohshëm – Vlerësim i detajuar i Gjenerimit të KEK-ut. Burimi: http://ero-ks.org/Tarifat/2012/Vleresim_i_perkoshem_KEK_Gjenerim.pdf

⁶ Vlerësimi i përkohshëm – Raporti i Detajuar mbi Operatorin e Sistemit të

Humbjet Teknike dhe Komerciale janë faktor të rëndësishëm në përcaktimin e çmimit. Në vitin 2011, 38.15 përqind⁷ e energjisë së injektuar vetëm në rrjetin e distribucionit ishte humbur. E shprehur si shifër absolute e energjisë, këto humbje kapin shifrën 1,786,177,000 KWh. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2011, çmimi mesatar i energjisë elektrike ishte 5.76 euro cent për KWh.⁸ Shumëzimi i sasisë së energjisë së humbur me çmimin mesatar do të na jepte shifrën monetare të energjisë së humbur, shifër e cila zë shumën e përafërt me 100 milion euro. Mirëpo, meqë në këto humbje hyjnë edhe humbjet teknike, të cilat nuk mund të zvogëlohen në zero, atëherë një shifër reale e energjisë së humbur rezulton të jetë rreth 75 milion euro⁹.

ZRRE gjatë procesit të shqyrtimit të tarifave cakton vlerën e humbjeve të lejuara, të cilat duhet të jene të “mjaftueshme që të nxisë Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) dhe Operatorin e Sistemit të Transmisionit (OST)/Operatorin e Tregut (OT) të reduktojë humbjet në shpërndarje dhe transmision, për të mos vendosur kosto mbi OSSH-në dhe OST/OT-në në atë mënyrë që të kërcënohet pozita e tyre financiare.”¹⁰ Humbjet e lejuara llogariten në të hyrat maksimale të lejuara për të licencuarit, dhe rrjedhimisht në çmim të energjisë elektrike.

Importet dhe eksportet¹¹ janë edhe një aspekt i çmimit të energjisë elektrike, edhe pse nuk është i natyrës së njëjtë me faktorët e lartpërmendur. Në vitin 2011, Kosova importoi rreth 14 përqind të konsumit të saj total, ndërsa eksportoi rreth 5 përqind të gjenerimit. Zakonisht energjia e importuar është e kohës së pikut apo e blerë njëditë-para. Në anën tjetër, energjia eksportohet gjatë kohës së natës kur kërkesa vendore bie nën nivelin e gjenerimit. Kjo bën që çmimi i importit të jetë shumë më i lartë sesa ai i eksportit. Kosova, gjatë vitit 2011, importoi energji në vlerë prej 54.6 milion euro me çmim 69.66 euro për MWh, ndërsa eksportoi energji në vlerë prej 12.5 milion euro me çmim 45.05 euro për MWh. Meqë çmimi i importit është shumë më i lartë sesa kostoja e prodhimit të energjisë dhe çmimi i eksportit është me i vogël sesa çmimi i konsumit brenda tregut të Kosovës, importet dhe eksportet ndikojnë negativisht në çmimin e energjisë elektrike.

Faktori i efikasitetit është faktor të cilin ZRRE përcakton gjatë shqyrtimeve periodike. Ky faktor ka për qëllim caktimin e përmirësimit të performancës, apo përmirësimin e efikasitetit të një operatori ekonomik në fushën e energjisë. Ky faktor merr parasysh rritjen e produktivitetit të punëtorëve dhe grumbullimin e eksperiencës menaxhuese të cilët me sasinë e njëjtë të mundit japin më shumë rezultate; apo thënë thjeshtë produktiviteti i tyre rritet. Do të thotë, si faktor është i vlefshëm vetëm për koston operative dhe të mirëmbajtjes.

Shpërndarjes http://ero-ks.org/Tarifat/2012/Vleresim_i_perkoshem_OSSH_FPEE.pdf

⁷ Raporti Vjetor 2011, ZRRE

⁸ Ibid.

⁹ Nën supozimin konservativ që humbjet teknike nuk mund të ulen më shumë se 10 përqind.

¹⁰ Rregulla për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të transmisionit dhe të tregut, dhe Rregulla për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të shpërndarjes, ZRRE <http://ero-ks.org/>

¹¹ Nuk përfshihet shkëmbimi i energjisë.

4. Çfarë ka mbajtur çmimin e ulët të energjisë elektrike deri më tash?

Ka disa faktorë që deri më tash e kanë mbajtur çmimin e ulët të energjisë elektrike, mirëpo që jo domosdo do të vazhdojë të jetë njëjtë edhe në të ardhmen. Njëri nga këta faktorë është teknologjia e vjetruar e cila ende përdoret. Kjo do të thotë që teknologjia që përdoret sot është zhvlerësuar deri në pikën që nuk paraqet kosto ekstra për prodhimin e energjisë elektrike. E njëjta vlen edhe për rrjetin e energjisë elektrike, edhe pse në masë shumë më të vogël.

Faktori i dytë që ka ndikuar në mbajtjen e çmimit të ulët të energjisë elektrike në Kosovë, janë grantet dhe investimet e huaja në formë të ndihmës. Në rast të investimit përmes granteve apo donacioneve të huaja në sektorin e energjisë, atëherë për ato mjete të cilat janë investuar nuk ka kthim në investim, njëjtë siç nuk llogaritet as zhvlerësimi për ato mjete¹². Vetëm gjatë viteve 2007-2012, komuna të ndryshme në Kosovë kanë investuar rreth 800,000 euro në rrjetin e distribucionit të KEK-ut¹³. Në investime kapitale në rrjetin e transmissiionit, janë investuar 22.4 milion euro nga Qeveria e Kosovës¹⁴. Në anën tjetër prej vitit 1999 deri në 2007, EU ka asistuar me rreth 400 milion euro në projekte të ndryshme energjetike¹⁵. Të gjithë këto shuma nuk japin vlerën e vërtetë, e cila është shume më e madhe, të granteve dhe donacioneve të dhuruara për investime kapitale në sektorin energjetik të Kosovës. Një shumë aq e madhe e donacioneve dhe granteve ka ndihmuar që çmimi i energjisë elektrike të mbetet i ulët.

Faktori i tretë i cili ka ndikuar në mbajtjen e ulët të çmimit të energjisë elektrike janë edhe shumat e mëdha të subvencioneve të Qeverisë së Kosovës drejtuar KEK-ut. Shuma e saktë e subvencioneve të Qeverisë së Kosovës drejtuar KEK-ut prej periudhës së pasluftës nuk dihet. Mirëpo, vetëm në vitet 2009-2011 KEK-ut i janë lejuar të hyra nga subvencionet rreth 145.84 milion euro. Dhe duhet cekur që në vitet e fundit ka qenë qëllim i Qeverisë që shuma e subvencioneve të zvogëlohet për shkak të mos qëndrueshmërisë financiare dhe deficitit buxhetor¹⁶.

Faktori i katërt që ka ndikuar në mbajtjen e ulët të çmimit të energjisë elektrike është edhe mungesa e investimeve të mjaftueshme në uljen e ndotjes si rrjedhojë e neglizhimit të ambientit dhe efekteve anësore të ndotjes nga KEK-u. Kostoja e madhe e filtrave të ajrit dhe investimeve tjera, benefitet e të cilave nuk i shkojnë korporatës por shoqërisë në përgjithësi, nuk kanë qenë nxitëse për KEK-un që të investojë. Si

¹² http://ero-ks.org/Rregullat/Rregullat_2011/Rregulla_per_cmime_e_Gjenerimit.pdf

¹³ http://advmediahouse.com/gap/documents/87976_ProcesiiprivatizimitteKEDSdhevleraetij.pdf

¹⁴ Raporti i Performancës së Ndërmarrjeve Publike 2010 http://www.gapmonitor.org/data/Image/docs/Rap-NP-shqip_1.pdf

¹⁵ Për informata më të detajuara rreth investimeve të EU në sektorin e energjisë, ju lutem vizitoni vegëzen më poshtë:

<http://ec.europa.eu/enlargement/archives/ear/publications/main/documents/EnergyKosovoJuly07.pdf>

¹⁶ Zvogëlimi i subvencioneve është njëra ndër pikat e marrëveshjes Stand-By ne mes te Qeverise se Kosovës dhe Fondit Ndërkombëtar Monetar.

rezultat, çmimi energjisë elektrike ka rezultuar të jetë më i lirë, mirëpo në dëm të shëndetit të popullatës dhe ambientit.

Faktori i pestë i cili ka mbajtur të ulëta çmimet e energjisë elektrike është fuqia e lirë punëtore në krahasim me vendet tjera. Ky faktor nuk është i natyrës së faktorëve të tjerë të lartpërmendur, megjithatë ka ndikim në çmim. Sikur të gjithë faktorët tjerë të ishin të nivelit të njëjtë me vendet tjera, por pagat të mos ishin, atëherë çmimi i energjisë elektrike në Kosovë do të duhej të ishte më i lirë. Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura pagat mesatare të Kosovës, vendeve të rajonit, dhe një mesatare të Bashkimit Evropian.

Vendi	Paga mesatare (Euro për muaj)
Kosova	310*
Bosnja dhe Hercegovina	622
Maqedonia	491
Serbia	461
Shqipëria	246
Mali i Zi	715
Kroacia	1,054
EU27	2,776

*Paga mesatare e Kosovës është llogaritur vetëm nga pagat e sektorit publik.
Burimi: The Vienna Institute for International Economic Studies (2011) dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës (2011).

5. Çmimi i energjisë elektrike në Kosove në raport me vendet tjera të rajonit

Çmimi mesatar i energjisë elektrike pa taksa në Kosovë gjatë vitit 2011 për amvisëritë me konsum deri në 5,000 kWh ishte 5.76 euro/cent për kWh. Në krahasim me vendet e rajonit, Kosova paguan më shumë për kWh se sa Serbia dhe Maqedonia, ndërsa çmim më të ulët se Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, dhe Mali i Zi. Kurse 27 vendet e Bashkimit Evropian në mesatare paguajnë rreth 14.16 cent për kWh¹⁷, apo rreth 3 herë më shumë sesa Kosova. Për sa i përket taksave në energji, Kosova paguan 16%, përderisa mesatarja e shteteve të rajonit është 16.3%. Duhet cekur që në kalkulimin e përqindjes së taksës së Kosovës nuk janë futur edhe taksat tjera.

¹⁷ Electricity - domestic consumers - bi-annual prices - new methodology from 2007 onwards
<http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do>

Analiza e kostos reale të energjisë elektrike				
Nr.	Shteti	Çmimi i energjisë elektrike me pakicë (€c/kWh)*	BPV për kokë banori	Diferenca në % e kostos reale të energjisë elektrike në krahasim me shtetet e rajonit ¹⁸
1	Kosova	5.76	€ 4,977.39	
2	Shqipëria	6.62	€ 6,789.32	30%
3	Kroacia	9.18	€ 14,908.48	56%
4	Bosnja dhe H.	6.39	€ 8,200.00	44%
5	Magedonia	5.37	€ 8,620.56	55%
6	Mali i Zi	7.37	€ 10,285.51	48%
7	Sllovenia	10.79	€ 20,640.16	62%
8	Serbia	5.23	€ 9,099.50	59%
9	EU27	14.16	€ 25,200.00	58%
			Mesatarja:	51%

* Çmimet janë Pa TVSH

Burimi: EUROSTAT, Zyra e Rregullatorit të Energjisë, Energy Agency of RS


Përkundër faktit që kosovarët paguajnë, në terme absolute, 5.76 €cent për kWh, mundësitë financiare të tyre janë të vogla dhe nuk përballojnë një çmim më të madh të energjisë elektrike. Kjo reflektohet edhe në të ardhurat për kokë banori (shih tabelën më lart), e matur me BPV për kokë banori, ku Kosova është shteti me numrin më të vogël.

Në mënyrë që të vlerësojmë ndikimin ekonomik të çmimeve të energjisë elektrike, jemi fokusuar në analizën e kategorisë së amvisërisë, për të shikuar ndikimin ekonomik tek qytetarët e zakonshëm duke përfshirë në llogaritje edhe standardin jetësor. Analizimi i çmimeve të energjisë elektrike me pakicë për amvisëritë si përqindje e BVP-së për kokë banori, në aspektin e PFB (Paritetit të Fuqisë Blerëse), na mundëson të vlerësojmë koston reale të energjisë elektrike në Kosovë në krahasim me shtetet e tjera në rajon dhe ato në Bashkim Evropian. Faktori i PFB-së shërben për të krahasuar vlerën e parasë në shtete të ndryshme të cilat janë përfshirë në këtë analizë. Ky faktor, respektivisht, na mundëson të krahasojmë fuqinë blerëse të parasë në aspektin se sa mallra dhe shërbime mund të blihen me shumën e njëjtë të parave në dy shtete të ndryshme.

Nëse shikojmë pasqyrën e çmimeve të energjisë elektrike (€/kWh) për kategorinë e Amvisërisë, Kosova zë vendin e katërt sa i përket çmimit të energjisë elektrike me pakicë, pas Shqipërisë, Kroacisë dhe Sllovenisë, të cilat janë më të shtrenjta. Sidoqoftë, kjo ndryshon tërësisht kur si faktor marrim indikatorët për standardin e jetesës së secilit shtet. Siç mund të shihet në grafikonin e mëposhtëm, të dhënat tregojnë që qytetarët e zakonshëm në Kosovë, në terme të kostos reale, paguajnë mesatarisht 52% më shumë për energji elektrike sesa qytetarët në cilindo shtet

¹⁸ Llogaritur në bazë të relacionit mes çmimit të energjisë elektrike me pakicë kundrejt BPV për kokë banori në aspektin e PFB (Bruto Produkti Vendor për kokë banori në aspektin e Paritetit të Fuqisë Blerëse)

tjetër në rajon apo në BE. Sa për ilustrim, mund të marrim krahasim me shtetin fqinj të Malit të Zi. Përderisa Kosova ka rreth 400,000 klientë në kategorinë e amvisërisë sa i përket energjisë elektrike, Mali i Zi ka rreth 200,000 të tillë, ndërsa qytetarët e zakonshëm në Kosovë paguajnë hiq më pak se 48% më shumë për koston reale të energjisë elektrike në krahasim me fqinjët e tyre në Malin e Zi.



Burimi: BB Indikatorët e Zhvillimit, EUROSTAT, Rregullatorët e Energjisë në shtetet përkatëse

6. Implikimet e ngritjes së çmimit të energjisë elektrike

Buxheti i kosovarëve është relativisht i vogël. Për konsum në vitin 2011 në mesatare një kosovar harxhonte hiq më shumë se 1,210 euro në vit, apo pak më shumë se 100 euro në muaj.¹⁹ Një buxhet i tillë i vogël nuk lejon për shumë shpenzime tjera jashtë atyre, për të plotësuar nevojat ekzistenciale. Andaj, kategoria e ushqimit dhe pijeve jo-alkoolike, dhe e banimit kontribuojnë me përqindjet më të larta në konsumin total, me 38 dhe 31 përqind respektivisht, apo 69 përqind të kombinuara.

Ngritja e çmimit të energjisë pikë së pari do të rriste përqindjen e konsumit të kategorisë së banimit. Duke supozuar rritje jo-proporcionale të çmimit të energjisë elektrike dhe buxhetit të ekonomive familjare, kjo përqindje do të rritej në dëm të shpenzimeve tjera, që do të thotë që një rritje eventuale do të sakrifikonte konsumin e fushave tjera. E meqë në fusha tjera përfshihet edhe ushqimi, rritja e çmimit të energjisë elektrike do të ndikojë edhe në nivelin e konsumit të produkteve që janë të nevojës ekzistenciale.

Përveç efekteve në konsum, rritja e çmimit të energjisë elektrike do të ndikoj gjithashtu edhe në sasinë e parave të kursyera. Kjo ndodh pasi që, për të kompensuar për rritjen e shpenzimeve për banim dhe për të mos sakrifikuar uljen e shpenzimeve në fushat tjera, kursimet do të duhet të kthehen në para të gatshme për shpenzim. Në plan të gjatë, ky efekt mund të reflektonte negativisht në aftësinë

¹⁹ Konsumi i përgjithshëm në Kosovë 2003-2011, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

financiare për të planifikuar investime të ndryshme kapitale apo në kapitalin njerëzor.

Rritja e çmimit të energjisë elektrike do të ketë edhe efekte indirekte. Një efekt indirekt është rritja e kostos së bukës, si njeri ndër produktet bazë të çdo qytetari. Buka dhe drithërat përbejnë 8 përqind të buxhetit të ekonomive familjare²⁰. Për furrat e bukës që nuk funksionojnë me energji elektrike, kjo e fundit kontribuon rreth 5 përqind në çmimin final të bukës²¹. Kjo përqindje është shumë më e madhe në ato furra të cilat funksionojnë me energji elektrike, të cilat kanë tendencë të gjinden në pjesët urbane të qytetit, ku burimet tjera të energjisë, si drunjtë dhe qymyri, janë më të papërshtatshme për përdorim si pasojë e ndotjes që ato lirojnë dhe hapësirës së madhe për ruajtje. Përqindja e lartë e participimit të bukës në buxhetin e ekonomive familjare bën që ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe rrjedhimisht i bukës, sado i vogël të jete, të ketë efekt të madh në buxhetin e qytetareve.

Këto efekte të rritjes së çmimit të energjisë elektrike shihen qartë edhe në ndryshimin që do të kenë në Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK). Pësia e kombinuar që kanë kategoria e energjisë elektrike dhe bukës në përcaktimin e IÇK-së është 18 përqind²². Atëherë, ngritja e çmimit të energjisë elektrike për 10 përqind, do të ndikonte në rritjen e IÇK-së për 0.86%. Po t'i fusim në kalkulim edhe efektet tjera indirekte, atëherë shumë lehtë mund të thuhet që ngritja e çmimit të energjisë elektrike do të ndikojë në rritjen e IÇK-së për 1 përqind.

Implikim tjetër që rritja e çmimit të energjisë elektrike do të ketë, është rritja e kostos së prodhimit për prodhuesit vendor. Meqë Kosova varet nga importet në masë të madhe, ky aspekt i efektit të ngritjes së çmimeve shkon pa u vrenjtur. Madje edhe rritja e IÇK-së është shumë më e vogël për shkak se ndryshimet në çmime të energjisë elektrike nuk reflektohen në importe. Por, në planin afatgjatë rritja e çmimit të energjisë elektrike do të ketë efekt shumë negativ në prodhimin vendor.

²⁰ Ibid.

²¹ Interviste me kryetarin e Shoqatës së Furretareve të Kosovës, Halit Xoxa. 21 Shkurt 2012

²² Agjencia e Statistikave të Kosovës përdore kategorinë "Buke dhe Drithëra" dhe "Rryma, gazi dhe lëndë djegëse të tjera" në përcaktimin e IÇK. Individualisht këto dy kategori kane peshe 10.1 % dhe 7.9 % respektivisht.

7. Përfundimet dhe Rekomandimet

Duke marrë parasysh që pjesa dërmuese e buxhetit konsumues shpenzohet për nevoja ekzistenciale, ngritja e çmimit të energjisë elektrike do të ishte një barrë e rëndë për qytetaret. Kjo barrë mund të rezultojë uljen e arkëtimit të energjisë dhe rritjen e humbjeve komerciale, si pasojë e rritjes së stimulimit për vjedhje të energjisë. Gjithashtu, kjo barrë mund të shkaktojë pakënaqësi sociale që në rast përkeqësimi mund të shkaktojnë trazira sociale.

Në bazë të të gjeturave të këtij punimi, Instituti GAP dhe FIQ rekomandojnë:

- Humbjet komerciale të eliminohen në kohën më të shpejtë të mundur, ndërsa humbjet teknike të zvogëlohen deri në masën optimale. Zvogëlimi i humbjeve do të binte të ardhura shtesë të licencuarve dhe do të ofroj më shumë energji për konsumatorët. Kjo energji do të ketë çmim shumë më të ulët sesa ai i importit. Rrjedhimisht, çmimi do të zvogëlohet prej të hyrave më të mëdha për të licencuarit dhe prej zvogëlimit të importit të energjisë.
- Qeveria e Kosovës duhet të ulë TVSH-në për energjinë elektrike. Përqindja e uljes së taksës do të reflektojë direkt në përqindjen e uljes së çmimit të energjisë elektrike.
- Qeveria e Kosovës duhet të ulë tantimën për linjitin i cili do të përdoret në Kosovë.
- Faktori i efikasitetit, i cili pritët të filloj së aplikuari nga ZRRE, duhet të jetë më i lartë në fillimin e aplikimit të tij në mënyrë që të kompensojë për periudhën e gjatë të keq-menaxhimit të kompanive publike të fushës së energjisë.



Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.



Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), është organizatë joqeveritare me fokus në Filantropi, Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Sektorin e Sigurisë. FIQ, po ashtu përkrahë projekte për qytetari aktive dhe mbrojtje të ambientit, përmes Programit të Granteve. FIQ është themeluar në vitin 2000, nga një grup i vogël njerëzish, të cilët kanë parë nevojën e aktivizimit të qytetarëve në proceset vendim-marrëse, si pasojë e luftës së Kosovës, në periudhën 1998-1999. Nga të qenit organizatë e koncentruar në çështjet e sigurisë dhe aktivizimit qytetar, nga formimi i saj, FIQ, me qëllim për të forcuar rolin e qytetarëve, ka rritur fushat e veprimit edhe në programe tjera si grantdhënia, filantropia dhe zhvillimi i qëndrueshëm.